



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 817 Prot.

Tiranë, më 07.06 2019

VENDIM Nr. 136, datë 28.05.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 48 dhe 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 28.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Rigjenerimi Urban i shëtitorës ekzistuese "Naim Frashëri" në Sarandë"*-subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Rigjenerimi Urban i shëtitorës ekzistuese "Naim Frashëri" në Sarandë"*-subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit, realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Skënder Muçaj, sipas përcaktimeve dhe kushteve të pikave të mëposhtme të këtij vendimi.
2. Subjekti Fondi Shqiptar i Zhvillimit duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Rigjenerimi Urban i shëtitorës ekzistuese "Naim Frashëri" në Sarandë", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Punimet e zbatimit të projektit duhet të fillojnë nga skajet fundore të shtrirjes së këtij projekti, ndërsa në pjesën e qëndrore ato do të zbatohen pas depozitimit të *Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik nënujor të kësaj zone* dhe marrjes së vendimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për të.
4. "Projekti për Mbrojtjen dhe Konservimin e murit të Portës Hyrëse, antike, të qytetit të Sarandës", i cili do të merret në konsideratë tek konsulenca tjetër e projektit të PZHIUT për qytetin e Sarandës, të depozitohet pranë ASHA dhe Institutit të Monumenteve të Kulturës "Gani Strazimiri" me qëllim shqyrtimin e vendimmarrjen për të.
5. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**